



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Puke, 12 . 12.2025

Nr.2186 prot.

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 12. 12 .2025 :
Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjegjaj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Dhjetor 2025

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.10.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator** 2025.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor** 2025.
4. Projekt-vendim : “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026”
5. Projekt-vendim : “Per proçedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2026”
6. Projekt-vendim : “Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin ”Ali Bytyçi” për vitin shkollor 2025-2026.
7. Projekt-vendim : ”Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026”
8. Projekt-vendim : ”Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026”

9. Relacion shpjegues dhe informues ” Mbi raportin e performancës së Bashkisë Pukë për vitin 2024”

10. Të tjera.

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites, dhe mori Vendimin nr.7 date 12. 12 .2025, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit ne fund te procesverbalit.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 18. 12. 2025 , nga ora 14³⁰ deri ne oren 16⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari I keshillit

Gjon Gjoka





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA**

Nr. 2186/1 prot.

Puke, me 12.12.2025

VENDIM

Nr. 7 datë 12.12.2025

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 12.12.2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet më datë 19.12.2025, ora 13³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

